



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA  
KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
*Qeveria-Vlada-Government*



**SEKRETARIATI - KËSHILLIT KOMBËTAR PËR ZHVILLIM EKONOMIK TË KOSOVËS**

**PROCESVERBAL**

**Mbledhja e Njëmbëdhjetë e KKZHE-së**

**Prishtinë, 14 prill 2020**

Takim virtual

Prishtinë

Mbështetur nga:



## FTESË

### TAKIMI VIRTUAL I KËSHILLIT KOMBËTAR PËR ZHVILLIM EKONOMIK- 14 PRILL 2020

Të nderuar anëtarë të Këshillit Kombëtar të Zhvillimit Ekonomik,

Ju informojmë që takimi i radhës i Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik të Kosovës me kërkesë të Kryeministrit të Republikës së Kosovës z. Albin Kurti, do të mbahet të martën, me datë **14 prill 2020**, në ora **9:00 - 10:30**.

Për shkak të rrethanave të krijuara nga pandemia Covid-19, Ju kërkujmë mirëkuptim, që takimi do të mbahet në formë virtuale.

Pjesëmarrja nga secila Ministri dhe Odë Ekonomike është e lejuar me vetëm nga një përfaqësues. Për cdo sqarim shtesë do të vazhdojmë të ju informojmë në ditën në vijim.

Ju lutem gjeni të bashkangjitur agjendën e takimit. Pjesëmarrjen e konfirmoni tek [fjolla.metaj@rks-gov.net](mailto:fjolla.metaj@rks-gov.net) (00 383 44 636 240).

Ju falemnderojmë për mirëkuptimin e juaj.

Sekretariati i KKZHE-së

## **RREGULLAT E TAKIMIT : TAKIMI VIRTUAL I KËSHILLIT KOMBËTAR PËR ZHVILLIM EKONOMIK- 14 PRILL 2020**

Të nderuar anëtarë të KKZHE,

Faleminderit që keni konfirmuar pjesëmarrjen në Takimin e 11-të të KKZHE që do të mbahet në formë virtuale nëpërmes CISCO Webex Meetings.

Takimi mbahet nesër, **14/04/2020 nga ora 09:00-10:30**. Për të siguruar mbarëvajtje sa më të mirë të takimit, me këtë email po ju përcjellim informacionet e nevojshme për pjesëmarrje.

Është e rëndësishme të latë që agjenda të respektohet.

### **Si të qaseni në takimin CISCO Webex Meetings?**

Në qoftë se provoni qasjen nga paisjet desktop:

1. Në emailin që keni pranuar sot më herët e gjeni ftesën e cila do të ju lidhë me kanalën/platformën ku do të zhvillohet takimi. (e-mail që ka në subject: Webex meeting invitation: Takimi Virtual i Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik- 14 Prill 2020)
2. Pasi që të klikoni mbi link, do të ju shfaqen dy opsione  
Të kyçeni nëpërmjet aplikacionit CISCO Webex, në qoftë se e posedoni app-in ose,  
Të vazhdoni me opsionin “Join from your browser”;
3. Pas kësaj ju kërkohet t'i vendosni të dhënat tuaja për tu identifikuar;
4. Hapi i fundit për ju do të jetë të klikoni mbi butonin “Join Now”.

Në qoftë se provoni qasje nga smartphone-s, atëherë ju duhet të:

1. Së pari të shkarkoni aplikacionin Webex Meet;
2. Edhe në qoftë se nuk keni llogari në office 365, ju mund të vazhdoni duke klikuar mbi opsionin “Join as a guest”, ku do të ju kërkohet të shkruani emrin tuaj, si dhe,
3. Hapi i fundit për ju do të jetë të klikoni mbi butonin “Join Now”

### **Rregullat e mirësjelljes**

Në mënyrë që të zhvillohet takimi si duhet, lutemi që të u përmbaheni rregullave të mëposhtme:

1. Nëse nuk flisni atëherë sigurohuni që mikrofonin juaj është i ndalur në mënyrë që fjalimet tjera të mbahen në qetësi. Administruesi i takimit do të sigurohet që të gjithë mikrofonet të

jenë të ndalur, por në rastet kur përfundoni fjalimin, duhet të siguroheni ta ndalni mikrofonin vetë.

2. Nëse nuk flisni atëherë çaktivizoni videon tuaj sepse kështu mund të rrisni kualitetin e transmetimit.

3. Përdoreni funksionin Chat nga Webex që të shtroni pyetje nëse keni ndonjë paqartësi.



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik të Kosovës  
Sekretariati i KKZHE-së

**Mbledhja e Njëmbëdhjetë**  
E martë, 14 Prill 2020, ora **09:00**  
Prishtinë

## **Rendi i ditës**

- 09:00 – 09:10 Fjala Hyrëse – Kryeministri i Kosovës, z.Albin Kurti
- 09:10 – 09:20 Gjendja e sektorit privat dhe masat e ndërmarra gjatë pandemisë Covid-19 – Ministrja e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, znj.Rozeta Hajdari
- 09:20 - 09:30 Pakoja Emergjente Fiskale (01-19-30-03-2020 MFT) – Ministri i Financave dhe Transfereve, z.Besnik Bislimi
- 09:30 - 09:40 Pikat kyqe të raportit mbi masat e propozuara për Qeverinë e Kosovës znj.Lindita Daija
- 09:40 – 10:10 Diskutime nga Odat Ekonomike/Shoqata të Bizneseve:
- Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës - z.Berat Rukiqi
- Drejtori i Odës Ekonomike Amerikane të Kosovës - z.Arian Zeka
- Kryetari i Odës së Afarizmit - z.Skender Krasniqi
- 10:10 – 10:15 Prezantimi i Vendimit mbi Grupin Koordinues për Covid-19 – Ministrja e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike - znj.Rozeta Hajdari
- 10:15 – 10:20 Konkludimi i takimit

**TABELA E PJESËMARRËSVE**

Albin Kurti	Kreministër i Republikës së Kosovës	Prezent
Rozeta Hajdari	Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike	Prezent
Arben Vitia	Ministria e Shëndetësisë	Prezent
Besnik Bislimi	Ministria e Financave dhe Transfereve	Prezent
Lumir Abdixhiku	Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit	Prezent
Besian Mustafa	Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	Prezent
Hykmete Bajrami	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	Mungon
Albulena Haxhiu	Ministria e Drejtësisë	Prezent
Berat Rukiqi	Oda Ekonomike e Kosovës	Prezent
Arian Zeka	Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë	Prezent
Nora Hasani	Oda Ekonomike Gjermane në Kosovë	Prezent
Sazan Ibrahim	Asociacioni i Komunave të Kosovës	Prezent
Lumnije Ajdini	Aleanca Kosovare e Bizneseve	Prezent
Emrush Ujkani	Këshilli i Investitorëve Evropian	Prezent
Vllaznim Osmani	Klubi i Prodhuesve të Kosovës	Prezent
Skender Krasniqi	Oda e Afarizmit të Kosovës	Prezent
Saxhide Mustafa	Forumi Ekonomik i Grave	Prezent
Linda Shala	Forumi Ekonomik i Grave	Prezent
Arieta Vula Pozhegu	Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës	Prezent
Ibrahim Xhaka	Doganat e Kosovës	Prezent
Illir Murtezaj	Administrata Tatimore e Kosovës	Prezent
Neil Taylor	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim	Prezent
Vadim Deleu	Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë	Prezent
Dardane Peja	USAID	Prezent
Blerta Qerimi	Banka Botërore	Prezent
Lindita Daija	Sekretariati i KKZHE-së	Prezent
Gent Nushi	Sekretariati i KKZHE-së	Prezent
Dita Dobranja	Sekretariati i KKZHE-së	Prezent
Fjolla Metaj Gashi	Sekretariati i KKZHE-së	Prezent

## PROCESVERBAL NGA TAKIMI I NJËMBËDHJETË I KKZHE-SË

**Albin Kurti:** E nderuara Ministre Hajdari, i nderuar Ministër Bislimi, i nderuar Ministër Abdixhiku, i nderuar Ministër Vitia, i nderuar Ministër Mustafa. Të nderuar përfaqësues të Odave Ekonomike dhe Shoqatave të Bizneseve, të nderuar përfaqësuese nga Sekretariati i Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik, mirë se po takohemi në këtë mbledhje të Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik, në këtë kohë kaq të rëndësishme dhe të pazakontë.

Tashmë është e qartë se pandemia COVID-19 ka ndezur një krizë ekonomike në mbarë botën. Masat e marra për ta parandaluar dhe zvogëluar përhapjen e saj kanë ulur aktivitetet ekonomike në ekonominë reale. Në të njëjtën kohë, edhe oferta edhe kërkesa kanë pësuar shok negativ. Rrjedhimisht, më pak punohet, më pak prodhohet, më pak fitohet, dhe më pak shpenzohet.

Këtij procesi global të efekteve zingjirore në ekonomi, nuk ka pasur se si t'i shpëtojë as ekonomia jonë. Dhe, ndikimit negativ në të hyra, si pasojë e këtij procesi, nuk ka se si t'i shpëtojë as Qeveria jonë.

Paparashikueshmëria dhe pasiguritë rreth ngjarjeve të reja, që po shpalosen nga ora në orë, na bëjnë që ndonjëherë të veprojmë shpejt e ndonjëherë të kemi durim, në mënyrë që të mos gabojmë. E ndonjëherë edhe të përballemi me dilema të cilat në shikim të parë mund të duken të drejta, por që nuk janë të tilla.

Dilema mes shëndetit dhe ekonomisë është fallso. Një shoqëri e shëndoshë pa ekonomi të zhvilluar e ka zor të qëndrojë e tillë për shumë gjatë. Por, edhe një ekonomi pa një shoqëri të shëndoshë e ka zor të zhvillohet. Pra, na duhen të dyja: edhe shëndeti edhe ekonomia.

Dallimi mes tyre është vetëm çështje kohe. Po i larguam masat shumë vonë, do ta pësojë ekonomia e më pas edhe shëndeti. Po i larguam masat shumë herët, do ta pësojë shëndeti e më pas edhe ekonomia. Ajo që na duhet është optimizmi, gjë që si qeveri jemi duke e llogaritur para çdo vendimi që po marrim. Ka një lidhje direkte mes shëndetit të qytetarëve dhe shëndetit të ekonomisë. Shprehja i pasur e i shëndetshëm dhe i varfër e i sëmur po merr kuptim më shumë në këtë pandemi. Ne jemi vend i varfër dhe shumicën e popullit i kemi të varfër e kështu direkt më shumë të cenuar e të rrezikuar nga kjo pandemi.

Ata që me vite rrënuan sistemin shëndetësor nuk shëroheshin tek mjeku dhe spitali i shtetit, prandaj edhe nuk investuan në shëndetësinë publike, ama bash ata që na vodhën e mjeruan kaq shumë po na qajnë tash hallin më së shumti.

Ne duhet të kuptojmë se kurrë nuk mund të kemi një shoqëri të shëndoshë pa një ekonomi të zhvilluar, e aq më pak me një ekonomi të vjedhur.

Kur kemi vendosur që t'i mbyllim disa aktivitete ekonomike, kemi tentuar që ta maksimizojmë qarkullimin ekonomik duke e minimizuar dëmin shëndetësor. Kështu, mbi 82% të aktiviteteve ekonomike i kemi lejuar të qarkullojnë, dhe më pak se 18% i kemi mbyllur përkohësisht.

Duke e ditur se edhe mbyllja e përkohshme do të rezultojë në humbje, kemi dizajnuar një Pako Emergjente Fiskale prej 15 masash në vlerë prej rreth 180 milionë eurove. Para këtyre, 10 milionë Euro i kemi ndarë për Ministrinë e Shëndetësisë. Pra, deri tani, gjithsej për emergjencë i kemi ndarë 190 milionë Euro.

Meqë jemi në kohë pandemie, më lejoni që ta bëjë një analogji të trajtimit ekonomik me atë mjekësor. Pakoja Emergjente Fiskale është ndihma e parë që i jepet pacientit në emergjencë. Ajo nuk është terapia afatgjatë që i jepet për kurim. Sepse fillimisht duhet parandalim të përkeqësimit të gjendjes dhe stabilizim. E më pas vjen terapia afatgjatë për kurim dhe observim.

Kjo do të thotë që Qeveria në detyrë është duke e planifikuar pakon e dytë – atë të rimëkëmbjes ekonomike. Ajo do të jetë shumë më e madhe se pakoja emergjente dhe do të ketë kohështrirje shumë më të gjatë. Dhe, në këtë proces duhet të angazhohemi bashkërisht.

Angazhimi i përbashkët nënkupton edhe renditje të prioriteteve dhe llogaritje të përbashkët. Vetëm kështu mund të bëjmë llogaritje racionale.

Parashikimet aktuale për ndikimin në ekonominë e Kosovës variojnë nga ai më optimist – i një rënie vjetore të Bruto Produktit Vendor prej 1.6% sipas Bankës Botërore, deri tek ai më pesimist i një rënie vjetore prej 5% sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar. Natyrisht se këto llogaritje pritet të ndryshojnë në varësi të zhvillimeve, por duhet gjithnjë t’i kemi parasysh kur i shtrojmë nevojat dhe kërkesat.

Në mënyrë që ato të plotësohen, pra nevojat dhe kërkesat, nevojitet një harmonizim mes këndvështrimit mikroekonomik të bizneseve me atë makroekonomik të qeverisë.

Ne e dimë që rreth 99% e ndërmarrjeve në Kosovë janë mikro, me 1-9 të punësuar ku përgjithësisht janë biznese familjare një lloj vetë punësimi familjar. Dhe, natyrisht që jemi shumë të interesuar që këto ndërmarrje të kalojnë me sa më pak dëme. Poashtu, jemi shumë të interesuar që të kemi sa më pak dëme në punësim, prodhim, e eksport.

Gjatë hartimit të Pakos Fiskale për rimëkëmbje ekonomike, do t’i optimizojmë synimet dhe nevojat tona. Me synim solidaritetin, do të ndihmojmë më shumë aty ku ka më shumë nevojë. Me synim zhvillimin, do të ndihmojmë aty ku mund të rritet punësimi dhe eksporti.

Vetëm kështu mund të shpresojmë për një rimëkëmbje që do të jetë më shumë si shkronja V, pas rënies së shpejt do të ngritemi shumë shpejt, sesa le të themi si shkronja U, ku pas rënies së shpejtë do të na duhet kohë për t’u rimëkëmbur.

Duhet ta kemi parasysh që nga kjo krizë ekonomike nuk do të dalim ashtu siç jemi futur. Sa më parë që e kuptojmë këtë, aq më herët do të fillojmë të mendojmë për alternativa.

Krizat edhe historikisht jo vetëm tek ne janë sfida, por dhe mundësi. Tash është koha kur duhet të bëhemi inovativ. Mbase as mënyra se si kanë operuar shumë biznese dhe as masat e qeverisë nga e kaluara nuk do të jenë më relevante në një periudhë më afatgjatë. Prandaj, na duhet ta çlirojmë imagjinatën dhe të kërkojmë horizonte të reja.

Nëse diçka na ka mësuar kjo krizë është rëndësia e shtetit të zhvilluar dhe të qëndrueshëm, jo e njerëzve të fuqishëm, por e shtetit të fuqishëm. Po ashtu kjo krizë na ka mësuar se shëndetësia është zemra e shtetit. Varfëria, korrupsioni, degradimi i vlerës së edukimit dhe dijes ka bërë që shumë doktorë të rinj të lëshojnë Kosovën e shumë të tjerë të mos studiojnë fare shëndetësinë. Sot po e paguajmë këtë çmim të mungesës së infektologëve, të infermierëve e të doktorëve. Kanë ikur mjekët.

Kjo është kostoja e korrupsionit. Pra korrupsioni nuk është vetëm pasurim i pali gjuhë e vjedhje nga politikanët, por edhe dëmtim e vjedhje e së ardhmes.

Ekonomia të cilën do ta ndërtojmë pas kësaj krize duhet të punojë për të gjithë. Ajo është një ekonomi ku puna dhe përgjegjësia shpërblehet, ku secili merr pjesën që meriton dhe paguan kontributin që i takon. Një ekonomi e orientuar në mundësi dhe shanse të barabarta.

Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, presim dhe kërkojmë bashkëpunimin tuaj për të gjetur zgjidhjet më optimale. Veprimet e deritanishme të kësaj Qeverie kanë treguar përkushtimin tonë për ekonominë. Por, nëse masat e deritanishme nuk ua kanë mbushur syrin, masat që do t’i marrim tash e tutje do t’ua tejkalojnë pritjet. Për këtë, ju siguroj.

Faleminderit!

**Rozeta Hajdari:** Faleminderit Kryeministër. Do të marr fjalën tani unë, në cilësinë e Ministres së Ekonomisë, Punësimi, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike.

I nderuar Kryeministër i Republikës së Kosovës, të nderuar kolegë ministra, dhe përfaqësues të tjerë institucional, të nderuar përfaqësues të asociacioneve të biznesit, të nderuar përfaqësues të misioneve diplomatike të ShBA-ve dhe të BE-së në Kosovë, të nderuar përfaqësues të donatorëve ndërkombëtar në Kosovë dhe përfaqësues të BERZH-it, të nderuar anëtarë të Sekretariatit të KKZHE-së, zonja dhe zotërinj. Mirësevini në mbledhjen e Njëmbëdhjetë të Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik të Kosovës.



Ky takim i Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik të Republikës së Kosovës, si tejet i rëndësishëm nën udhëheqjen e Kryeministrit, është organizuar në bashkëpunim të ngushtë mes kabinetit të Kryeministrit, kabinetit të Ministrisë së Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike si dhe Sekretariatit të Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik (KKZHE-së). Besojmë që përmes kësaj platforme, ne do të vazhdojmë ta forcojmë bashkëpunimin tonë si Qeveri me sektorin privat në mënyrë gjithëpërfshirëse të dialogut publiko – privat ku do të adresojmë dhe trajtojmë çështjet ekonomike dhe problemet që ka sektori privat, si rezultat i përballjes me pandeminë COVID-19.

Siç e dini, Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, si Ministre përgjegjëse për bizneset dhe në shërbim të bizneseve, kemi dedikuar kohën tonë për të ndëguar shqetësimet e juaja në lidhje me zbatimin e masave të marra nga vendimet e Qeverisë dhe udhëzimet e Ministria, për mbrojtje dhe kujdes nga pandemia COVID-19 dhe në të njëjtën kohë për mbarvatjen e veprimtarive ekonomike gjatë kësaj kohe të situatës emergjente shëndetësore, duke ju ofruar mbështetje dhe komunikim të vazhdueshëm për të sqaruar të gjitha udhëzimet e dhëna për zbatimin e masave dhe urdhëresave përkatëse për veprimtaritë ekonomike.

Për shkak të turbave dhe rrezikut për përshpejtimin e përhapjes së pandemisë COVID-19, bizneseve, tregtisë me pakicë dhe disa sektorë industrialë u është kërkuar të ndalen gjatë muajit mars-prill 2020, duke rezultuar në humbje ekonomike dhe fluks të ulët të parave duke e bërë shumë sfiduese për të kapërcyer humbjen e biznesit.

Ne, përmes dialogut direkt me ju, me disa takime të përbashkëta me radhë, në kabinetin tim, poashtu edhe takime ndërministrorë me prezencë të më shumë se 4 ministrave, si dhe përmes Sekretariatit të Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik, kemi ndëguar dhe pranuar të gjitha rekomandimet e juaja të cilat janë reflektuar edhe në pakon emergjente fiskale, që do të prezantohet sot shkurt nga Ministri i Financave, si dhe do të komunikojmë e bashkëpunojmë tutje drejtë një plani sa më adekuat dhe të nevojshëm për përkrahjen direkte për bizneset, të cilat kanë pësuar humbje gjatë emergjencës shëndetësore COVID-19.

Jeni dëshmitar se kemi qenë në komunikim shumë të afërt me disa prej odave ekonomike dhe ju falenderoj tani si ministre dhe u jam mirënjohëse për kontributin e juaj që keni dhënë poashtu në draftimin e udhëzimeve për zbatimin e masave të ndërmarra të qeverisë. Ne, do të përqendrohemi edhe më shumë për mbështetje, për rimëkëmbjen e bizneseve, dhe zhvillimin e potencialit për krijimin e vendeve të punës, me cilësi të lartë dhe reforma për forcimin e rezistencës së ekonomisë tonë si dhe të konkurrencës.

Në këtë aspekt, dua të ju njoftoj se ne kemi rialokuar fondet e projektit të financuar nga Banka Botërore "Konkurrueshmëria dhe Gatishmëria për Export" ku afër 10 milion Euro, janë rialokuar për përkrahje direkte për bizneset, për të mbuluar humbjet. Dhe tutje në bashkëpunim të afërt me Ministrin e Financave kemi organizuar poashtu takime me shkëlqësinë e saj Ambasadorën Apostolova ku kemi kërkuar veprime të përbashkëta me Komisionin Evropian që të përkrahim sektorin privat për të mbuluar dëmet nga pandemia COVID-19.

Përveç paketës së Urgjencës Fiskale të Qeverisë së Kosovës, e cila u prezantua javën e kaluar, u përmend gjatë takimit se mbështetja e Komisionit Evropian do të mund të vihet në dispozicion deri në 160 milionë Euro përmes ndihmës makro-financiare, mbështetjes buxhetore, IPA granteve, për mbështetje të sektorit privat, bujqësisë si dhe lehtësimin e varfërisë.

Dhe, poashtu, gjersa e vlerësoj si shumë serioze nevojën për rimëkëmbje ekonomike nga pandemia COVID-19, kam kërkuar nga Komisioni Evropian që të marrë në konsideratë të gjitha potencialet për mbështetje buxhetore për Qeverinë e Kosovës, me ç'rast jemi pajtuar për takimet vijuese bashkë me Ministrin e Financave dhe Transfereve dhe me Komisionin Evropian.

Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike (MEPTINIS) ka marr poashtu të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar furnizimin e rregullt të tregut me drithë dhe miell, dhe për të stabilizuar çmimin e tregut të miellit. Në këtë rast kemi marr masat e

duhura në bashkëpunim me Ministrin e Bujqësisë dhe Minsitrin e Financave lidhur me masat për lehtësimin e masave për import të miellit në Kosovë dhe sigurimin e tregut me miell.

Gjithashtu, në mbështetje të Republikës së Kosovës dhe vendeve të rajonit, Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, i përkrahur nga Bashkimi Evropian ka marr nismën për hapjen e korridoreve të gjelbërta duke synuar mundësinë e qarkullimit të lirë të mallrave të domosdoshme. E di që ekonomia po goditet këto ditë, siç po ecë ritmi i pandemisë COVID-19 këto masa është e pashmangshme që të mos merren si pjesë e jetës dhe ekonomisë. E dini që mbrëm kemi deklaruar edhe masat e reja dhe kjo do të ndikoj poashtu edhe në mbylljen e disa sektoreve të bizneseve. Sot jemi duke punuar në listën e NACE kodeve se cilat veprimtari do të adresohen për tu mbyllur dhe cilat do të lejohen. Ato biznese të cilat do të lejohen për të vepruar dhe do të kenë adresimin e tyre përmes sistemit EDI të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) respektivisht dhe do t'ju lejohet qarkullimi i tyre i lirë në këtë situatë. Nëse këto masa nuk do të viheshin më heret apo më vonë humbjet janë më të mëdha të më shumë jetërave të qytetarëve dhe në ekonomi.

Prandaj, unë si Ministre në shërbim të ekonomisë, punësimit, tregtisë, industrisë, ndërmarrësisë dhe investimeve strategjike kërkoj mirëkuptimin e juaj sepse duhet të kemi bashkëpunim sa më të afërt në mënyrë që të sigurojmë zbatimin e këtyre masave dhe aq më shpejtë do t'i heqim këto masa. Prandaj ju falenderoj për bashkëpunimin tuaj dhe pakon tuaj do ta quaja më shumë një përmbledhje, sepse pako e zhvillon Ministria e Financave dhe ndoshta është një keqkuptim që është krijuar, por ju falenderoj si Ministre që keni përmbledhur të gjitha këto propozime në një dokument të përbashkët i cili do të prezantohet sot nga Sekretariati i Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik.

Tani ja jap fjalën Ministrit të Financave dhe Transfereve që të prezantoj Pakon Emergjente Fiskale dhe pas kësaj pako, ne do të jemi në komunikim më të afërt me ju në adresimin e çështjeve ekonomike, për t'i adresuar në pakon e dytë që është për përkrahje të bizneseve. Ju faleminderit!

**Besnik Bislimi:** Të faleminderit shumë Ministe. Në vend që të interpretoj pakon unë do të mundohem që të shpjegoj idenë prapa pakos dhe kompozimin e tij. Masat të cilat i ka ndërmarr Qeveria e Kosovës, synim primar kanë pasur mbrojtjen e shëndetit apo të jetës së qytetarëve, mirëpo si dëme anësore pastaj është dëmtuar ekonomia e vendit, sidomos në afatshkurtë. Është e qartë që synimi ka qenë që të shpëtohen sa më shumë jetë dhe mendoj që këtu jemi treguar shumë të sukseshëm, në pothuajse secilin indikator jemi më mirë se vendet e rajonit apo edhe pak më gjërë. Ndërkaq misioni ekonomik që i kemi dhënë vetit në bashkëpunim më përfaqësuesit e odave ekonomike ka qenë mbrojtja e sindikatave të punëtorëve, si dhe përfituesëve të skemave sociale ka qenë poashtu mbrojtja e qytetarit, e vendit, e biznesit dhe mbrojtja e komunave. Këto të fundit duke qenë gjithashtu shumë të ekspozuara.

U tha shumë mirë nga Kryeministri që adresimi i sfidave që dalin nga koronavirusi COVID-19, ka dy natyra. Janë problemet emergjente të pranishme në këtë fazë dhe janë problemet që kanë të bëjë me rigjallërimin e jetës ekonomike, e cila mund të filloj vetëm pasi të përfundoj faza emergjente dhe pasi të kemi më shumë informata për thellësinë e krizës. Kryeministri e përmendi se pritet që kriza ekonomike të shëndrrohet në një recesion, mirëpo kjo është parashikim për arsyen se zyrtarisht ne mund të flasim për recesion, vetëm pasi të kenë kaluar 6 muaj me rënie të vazhdueshme të ardhurave kombëtare. Në qoftë se ju kujtohen të dhënat e prezantuara nga Kryeministri, tha ka 1.6 % rënie ekonomike dhe magnituda mund të arrij deri në 5%, që nënkupton një margjinë të gabimeve prej 300%-400%. Domethënë aq shumë ka pasiguri, aq shumë ka mungesë të informatave të mjaftueshme edhe prej përvojave të deritanishme që nuk na lejojnë neve të dalim për të dhënë shifra se sa pritet me qenë rënia ekonomike, meqë kish me qenë shumë e pa përgjegjshme.

Më herët thash që pakoja në rrafshin ekonomik për synim ka të mbroj qytetarët, vendet e punës, bizneset dhe komunat. Mbrojtja e qytetarit ka pasur si synim me i adresu sfiat me të cilat ballafaqohen kategoritë më të rrezikuara në këtë periudhë, specifikisht nga varfëria ekstreme, si p.sh ata që përfitojnë nga ndihmat sociale, ata që përfitojnë pensione në vlerë nën 100 Euro, ata që humbin vendin e punës

gjatë kësaj periudhe, ata të cilët nuk kanë të ardhura meqë janë vetëm në mënyrë sporadike të lidhur me tregun e punës (punëtorë e krahut, ata që punojnë në tregjet e gjobëta ose ata që punojnë amviseri si kujdestarë) dhe janë komunitetet pakicë (rom, ashkalinjë dhe egjiptias). Për këtë kategori janë të dizajnuara pesë pika të pakos, që në rrafshin numerik nënkupton 1/3 e pakos i përkushtohet këtij grupi, do të thotë për nga kostoja financiare nuk janë as 1/6, pra 16% e pakos. Pastaj është mbrojtja e vendeve të punës dhe adresimi i nevojave të punëtorëve. Këtu janë 3-4 kanale përmes të cilave ne mbrojmë vendet e punës. Është pika 1.3 – për punëtorët e ndërmarrjeve të cilat hasin në vështirësi në dy muajt e parë fillimisht. Mirëpo në qoftë se kriza vazhdon, pastaj masa zgjerohet me pagën minimale të epërme e cila ka vlerën 170 Euro. Kjo e fundit jo si zëvendësim për kompenzimin që duhet me marr punëdhënësi, por si ndihmë që merr ai për me i mbijetu koston së fuqisë punëtoare. Poashtu ata përfitojnë nga pakoja 1.14, në qoftë se kanë punuar deri tash pa kontrata dhe tani punëdhënësi e shfrytëzon këtë hapsirë që gjatë muajit mars, t'i lajmëroj këta punëtor. Kam lexuar me kujdesë brengat që i kanë prezantuar përfaqësuesit e biznesit se a mund të ketë ndonjë masë ndëshkuese më vonë nga Administrata Tatimore? Hapja e dritares nënkupton që është një shancë me u shfrytëzu. Rrjedhimisht, punëdhënësit që e shfrytëzojnë këtë mundësi, nuk do të ballafaqohen me kurfar sanksione, përkundrazi ata do të përfitojnë. Krejt çka duhet bërë është që të pajisin punëtorët me kontrata 1 vjeçare dhe të sigurojnë që do të respektohen këto kontrata mbrenda asaj periudhe.

Masat 1.6 dhe 1.7, kanë të bëjnë me punëtorët e sektorit publik, të cilët për shkak të vendimeve tona në mënyrë proporcionale i janë ekspozuar riskut dhe masat 1.7 për punëtorët e sektorit privat, kryesisht ata të cilët drejtëpërdrejtë kanë punuar me klient, që janë shitësit e marketeve, farmacive, dhe furra të bukës. Edhe kjo masë është relativisht e vogël, mirëpo është e vështirë me ju drejtu këtij sektorit sepse kur i ndihmojmë biznesit për me e mbulu koston e pagave, në fakt mund të themi se kjo pako është për koston të biznesit dhe jo drejtëpërdrejtë të punëtorit.

Kategoria e tretë që mendojmë se ka pasur nevojë është kategoria e bizneseve. Ata janë mbrojtur edhe me masa jashtë pakos, p.sh shtyerja e obligimeve tatimore, dhe shtyerja e obligimeve ndaj sistemit bankar. E dijm që pjesa me sistemin bankar nuk është duke funksionuar ashtu si kemi shpresuar, dhe mendoj se ka nevojë për një intervenim pak më agresiv nga ana e Bankës Qendrore të Kosovës. Në mënyrë që bankat komerciale të mos e shfrytëzojnë fatkeqësinë e qytetarëve, mirëpo të dalin në ndihmë dhe të jenë partnerë me qeverinë për ta kaluar sa më lehtë këtë krizë. Pra ne jemi munduar me i nda të gjitha vështirësitë që mund të kenë bizneset në këtë periudhë. Poashtu u kemi marr përsipër mbulimin e gjysmës së qerasë për të ju dal në ndihmë bizneseve. Gjithashtu është prezantuar një vërejtje nga ana e komunitetit të biznesit, që shumica e paraparë për qiranë nuk është e mjaftueshme. Ne kemi marr informatat nga ATK për shumën e përgjithshme që bizneset paguajnë në formë të qiras në muajin shkurt dhe shumica totale ka qenë 12 milion Euro. Kjo shumë e cila ishte dasht me e pagu buxheti i shtetit, në rast se të gjitha bizneset konfirmojnë se kanë probleme me pagesën e qirasë. Kemi informata shumë të sakta nga noteret, se një pjesë e bizneseve të papërgjegjshme po vizitojnë zyrat e noterisë duke kërkuar ndyshimin e kontratave nga 500 Euro në 1500 Euro, me idenë që t'i marrin nga 750 Euro nga qeveria. Mirëpo baza jonë do të jetë pagesa e cila është bërë në muajin shkurt.

Pjesa tjetër ku bizneset kanë vështirësi, është edhe këtu kemi thënë se do të intervenojmë me likuiditet ose kredi me norma jashtëzakonisht të volitshme të interesit, 2-2.5 %, për arsye se pjesën tjetër mendohet me e mbulu me buxhetin e shtetit. Në të njëjtën kohë, përmes rritjes së Fondit për Garancinë e Kredive i kemi dhënë hapsirë sistemit bankar për të qenë më dorë lirë në adresimin e këtyre nevojave për likuiditet nga ana e sektorit privat. Kjo masë në tërësi kushton diku 190 milion Euro, përfshirë edhe ato që janë alokuar për shëndetësi, bashkë me rënien e të hyrave të cilat mund të shkojnë deri në 200 milion Euro, krijon probleme të mëdha buxhetore. Prandaj me të drejtë është pyetja se a mund të akomodoj të gjithë këtë humbje Ministria e Financave dhe Transfereve. Ne kemi kërkuar nga parlamenti që na munsësohet tejkaimi i Rregullës Fiskale, në mënyrë që të mund sa më lehtë t'i akomodojmë këto nevoja. Diqka e tillë ka ndodh në secilin shtet të rajonit me përjashtim të Kosovës, që një gjë e tillë nuk

është aprovuar. Përkundër dëshirës së parlamentit për të na bllokuar ne si qeveri, do ta akomodojmë Pakon Emergjente mbrenda buxhetit të qeverisë mirëpo problemet munden me na u paraqit me një fazë më të vonshme.

Parlamenti do të dal dhe me pako alternative, megjithse kompetencat i kanë shumë të qarta se kujt i përket të dizajnoj pako, e kush e ka ekzekutimin e pakos. Në qoftëse pjesëtarët si z. Hamza mendon se pakoja nuk është e mirë, ai mund të adresoj kritika dhe të na akuzoj se pakoja nuk është e mirë, nëse mendon të fitoj poena përmes kësaj. Mirëpo edhe ai dhe ne të gjithë e dijim se nuk kanë kurfar kompetenca për të dizajnuar pako alternative. Dihet se deputetët nuk mund të fillojnë asnjë nismë ligjore pa e pasur koston e kalkuluar buxhetore të cilën e bënë Ministria e Financave. Duke e pasur të qartë se cili është roli i ekzekutivit dhe cili është roli i legjislativit. Idetë të cilat po plasojnë në treg se “ne jemi më të mirë se qeveria,” me e shtjerr buxhetin dhe me e shpenzu buxhetin, janë jo të shëndosha, që synojnë me kriju përçarje dhe konfuzion. Prandaj nuk është mirë që komuniteti i biznesit me ra preh në këto kurtha, për arsye që vetë rritet bllokada. Komuniteti i biznesit mundet me u ndihmu vetëm nëse qeverisë i lejohen hapsirat për të intervenuar, në nevojat e biznesit. Në qoftë se, parlamenti vendos të na bllokoj atëhere veqse vështirësohet puna e qeverisë dhe do të ishte mirë sikur komuniteti i biznesit do të ja bënte të qartë parlamentit që nuk kemi nevojë për bllokada të tilla. Unë do e përfundoj këtu, në qoftë se keni ndonjë pyetje lirisht mundem me ju përgjigjem.

Faleminderit shumë!

**Rozeta Hajdari** – Faleminderit Ministër Bislimi.

**Lindita Daija** – Përshëndetje. Jam Lindita Daija, Udhëheqëse e Sekretariatit të KKZHE-së. Së pari dua të falenderoj Kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti për konfirmimin e këtij takimi, me propozim të sektorit privat. Falenderoj ministrat anëtarë të këtij Këshilli, asociacionet e bizneseve të cilat kanë qenë shumë aktive dhe të organizuara për dërgimin e rekomandimeve tek qeveria përmes Sekretariatit, si dhe donatorët ndërkombëtar, veçanërisht përfaqësuesit e BERZH-it, që njëheri edhe përkrahin punën e Sekretariatit në nivel profesional dhe analitik. Fillimisht ju falenderoj që për një kohë kaq të shkurtër kemi organizuar këtë takim kaq me rëndësi dhe besoj që kjo platformë është ideale dhe gjithëpërfshirëse.

Ne si Sekretariat kemi bërë një punë sfiduese, duke u munduar që të jemi sa më afër të gjithë përfaqësuesëve të sektorit privat, në anën tjetër kemi punuar në formulimin e shumë rekomandimeve të cilat mund t’i marr parasysh qeveria gjatë dizajnimit të pakove pasuese. E dijim që Pakoja Emergjente është bërë në një kohë tejet të shpejt, por shpresojmë që në pakon afat-mesme dhe atë të rimëkëmbjes ekonomike, do të dëgjohet zëri i sektorit privat dhe te mirren parasysh sfidat e biznesit. Në formë elektronike i kemi prauar rekomandimet nga të gjithë anëtarët e KKZHE-së. Dua të i cekë me radhë pasiqë është takimi i parë me këtë qeveri, ata janë: Oda Ekonomike e Kosovës, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare, Asociacioni i Komunave të Kosovës, Aleanca Kosovare e Biznesit, Këshilli i Investitorëve Evropian, Klubi i Prodhuesve të Kosovës, Oda e Afarizmit të Kosovës, Dhoma Ekonomike e Grave të Kosovës - G7, Forumi Ekonomik i Grave dhe Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës.

Kjo listë ka qenë para se të filloj mandatin qeveria e re, kuptohet ka hapsirë për t’u shtuar anëtar të ri, apo edhe ata që janë jo-aktiv mund të largohen. Gjithashtu anëtarat të tjerë të cilët janë edhe sot prezent, janë Administrata Tatimore e Kosovës dhe Doganat. Për herë të parë, Sekretariati ka filluar dhe punën analitike dhe kemi zhvilluar dy dokumente të cilat për shkak të kohës do t’i prezantoj në pika shumë kyqe. Por jemi siguruar që t’i përcjellim tek ju në formë elektronike në vesion të shkurtër dhe të gjatë, të cilat shpresojë të mirren parasysh nga të gjithë anëtarët një nga një. Në këto dokumente japim këshillën sa më të mirë dhe poashtu do të vazhdojmë të monitorojmë punën që do të bëhet në këtë aspekt. Unë po vazhdoj t’i prezantoj pikat: Dokumenti i parë është dërguar që me datë 30 mars, 2020 ku

kemi marr disa shembuj se çfarë mund të bëhet nga ana e qeverisë në aspekt të intervenimeve (kjo është dërguar para aprovimit të Pakos Emergjente). Disa pika janë marr parasysh dhe besoj se ka hapësirë që të bëhet më shumë në pakon përcjellëse. Vijat kanë qenë që të fokusohemi në stimujt fiskal të targetuar që po i përmend masat afatmesme: “qeveria të planifikoj transferin në sektor të biznesve të cilat kanë ngecur dhe janë izoluar plotësisht, linjave të buxhetit shëndetësor t’i jepet vëmendje e veçant, meqë shihet nevoja për të investuar në këtë drejtim është tejte e dukshme”. Gjithashtu kemi propozuar kthimin e kredive pa interes, riprogramimin e kredive, poashtu nga ana e qeverisë apo Administratës Tatimore është menduar të punohet në shtyrjen e obligimeve tatimore për një fazë deri në fund të qeshorit 2020. Gjithashtu, në takimet e ardhshme shpresojmë që të diskutohet më shumë për pikat e importit dhe eksportit për dy fazat e ardhshme dhe riprogramimin e qirasë. Me këtë do ta përmbyllja pikat kyçe të raportit të raportit të parë. Për t’ju lënë hapësirë tre përfaqësuesëve të asociacioneve të bizneseve, dhe në të njëjtën kohë, t’i i kërkoj fjale të tjerëve se për shkak të kohës së limituar dhe në takimet e radhës përmes rotacionit të gjithë do të mund të marrin fjalën.

Nëse e shikoni raportin e dytë që është, ndikimi i pandemisë edhe në nivel global apo atë të Kosovës, shihet se nuk është pritur një rritje më e madhe se 4% se sa ishte trendi i rritjeve në vijim, ndërsa rënia pritet të jetë diku afër 1%, një parashikim shumë optimist, deri në rënien 5% në rastin më të keq.

Sa i përket punësimit, rritja mesatare vjetore ka qenë deri në 2.9% dhe si rezultat i COVID-19 mund të kemi një rritje të këtij numri në 14-20%.

Produkti i mbrendshëm bruto, ku sektori me kontributin më të madh është tregtia me shumicë dhe pakicë, duke kontribuar me rreth 20%, e ndjekur nga prodhimi me 17% dhe ndërtimi me 13%. Nëse keni parë rekomandimet e shumta dhe sfidat kryesore, poashtu mund të themi se janë të fokusuar në këta sektor. Në parashikimet ekonomike dhe shifrave të BQK-së presim një rënie 2%-4%, mirëpo unë shpresoj të jetë skenari më optimist. Sipas parashikimeve të Bankës Botërore e kemi një rënie të Produktit Bruto prej 6% përderisa Fondi Monetar Ndërkombëtar parashikon një skenar më të rëndë që është deri në 5%. Analiza vetanake e Sekretariatit, sipas kontributit të sektorëve e paraqet këtë në formë më të rezervuar -2% deri në -4% rënien në rastin më të rëndë. Ajo çka kemi propozuar në fund është që të hartohen masa fiskale të synuara drejtë mbështetjes për sektorët më të goditur. Meqëgjendja po ndryshon nga minuti në minut dhe analizat tona janë në ekspozim të ndryshimeve. Një ndër sektoret më të prekura gjithashtu kemi konsideruar hotelet dhe restorantet, pra gastronomi dhe një problem shtesë në këtë sektor është se ka shumë prezencë të ekonomisë joformale. Ne si Sekretariat sugjerojmë që të zhvillohet një analizë hollësishme e rimëkëmbjes pas pandemisë bazuar në skenar të ndryshëm dhe kohëzgjatjen e pandemisë. Do ta mbyllja me kaq raportin e dytë dhe besoj se duhet ta cekë se duhet të vazhdojmë edhe bashkëpunimin me partnerët institucional financiar, të cilët janë duke punuar në ri-programimin e të gjitha projekteve të tyre. Besoj se vet organizimi i këtij takimi tregon gatishmërinë e qeverisë për bashkëpunim me sektorin privat dhe mund të them lirshëm se me këtë platformë është një formë ideale që të dëgjohet zëri i të gjithëve.

Faleminderit!

**Rozeta Hajdari:** Faleminderit Lindita. Ndoshta është mirë të zhvendosim praktikën e agjendës për shkak që deria është Kryeministri prezent të shpalosim pikën për krijimin e Grupit Koordinues ministror si vendim që do të vjen mbrenda KKZHE-së dhe të ju njoftoj se deri më tani në praktikën e KKZHE-së e kemi pa se kanë qenë të themeluara disa grupe punuese, dhe duke pasur parasysh edhe kërkesen e bizneseve edhe nevojën gjatë kësaj situatë është me rëndësi që të krijohet ky Grup Koordinues që jetë një mbështetje për tejkalimin e kësaj situatë. Prandaj Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik, i kryesuar nga Kryeministri i vendit propozon të themlohet Grupi Koordinues për trajtimin dhe adresimin e çështjeve ekonomike dhe problemeve që ka sektori privat, si rezultat i përballjes me pandeminë COVID-19. Ne kemi përcaktuar dhe anëtarët e grupit të cilët janë:

1. Rozeta Hajdari - Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike
2. Besnik Bislimi – Ministria e Financave dhe Transfereve
3. Besian Mustafa - Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
4. Lumir Abdixhiku - Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit
5. Arben Vitia - Ministria e Shëndetësisë
6. Xhelal Sveqlla (ushtrues detyre) – Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike
7. Emilia Rexhepi - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
8. Ilir Murtezaj – Administrata Tatimore e Kosovës
9. Ibrahim Xhaka (ushtrues detyre i Drejtorit të Përgjithshëm) - Dogana e Kosovës.

Nga odat ekonomike dhe asociacionet e biznesit kemi propozuar themeluesit e këtij këshilli që janë:

10. Berat Rukiqi – Oda Ekonomike e Kosovës
11. Arian Zeka – Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë
12. Skender Krasniqi - Oda e Afarizmit të Kosovës
13. Astrit Panxha - Klubi i Prodhuesve të Kosovës
14. Nora Hasani - Oda Ekonomike Gjermane në Kosovë
15. Linda Shala - Dhoma Ekonomike e Grave të Kosovës - G7

Grupi Koordinues si detyrë ka trajtimin dhe adresimin e çështjeve ekonomike dhe problemeve që ka sektori privat si rezultat i pëballjes me pandeminë COVID-19. Ky grup është i obliguar t'i propozoj qeverisë për miratim masat sipas legjislacionit në fuqi në përputhje me pikën dy të këtij vendimi. Sipas nevojave të punës dhe për realizimin e obligimeve të parapara në këtë vendim kryesuesi i këtij grupi koordinues mund të ftoj ekspert dhe përfaqësues të tjerë vendor dhe ndërkombëtar. Ky Grup Koordinues do t'i raportoj Kryeministrit si kryesues i KKZHE-së, në baza të rregullta ditore dhe sa herë që Kryeministri kërkon një gjë të tillë. Ndërsa Sekretariati i KKZHE-së, do t'i ofroj mbështetje analitike Grupit Koordinues në përmbushjen e detyrave të tij.

Prandaj derisa të gjithë jemi këtu dhe kemi prezencën e Kryeministrit propozoj votimin e këtij propozim-vendimi si Grup Koordinues mbrenda KKZHE-së. Ju lutem që votat të shkruhen në opsionin “chat” në platformën virtuale.

**Lindita Daija:** Faleminderit Kryeministër edhe një herë në emër të Këshillit dhe të të gjithë përfaqësuesëve të sektorit privat për mbajtjen e këtij takimi.

**Albin Kurti:** Ju falemnderit!

**Rozeta Hajdari:** Pas votimit vazhdojmë me prezantimet nga përfaqësuesit e odave ekonomike.

**Lindita Daija:** Për shkak të kohës më lejoni të propozoj që të vazhdojmë me prezantimet nëse jeni dakord edhe ju?!

**Rozeta Hajdari:** Në rregull.

**Lindita Daija:** Deri më tani kemi të gjitha votat “për” dhe vetëm një votë “kundër”.

**Rozeta Hajdari:** Faleminderit për votim. Atëhere meqë kemi marr shumicën e votave, pra ky vendim-propozim miratohet dhe vazhdojmë tutje me diskutimet nga përfaqësuesit e sektorit privat.

**Berat Rukiqi:** Ju përshëndes të gjithëve. Do të ishte mirë që Kryeministri të dëgjonte dhe fjalën e bizneseve por megjithatë po e mirëkuptojmë. Sot është data 14 prill, 2020 dhe unë besoj që ka qenë e domosdoshme me u taku me datën 14 mars qysh në fillim të pjesës kufizuese, që ka qenë e domosdoshme për ruajtjen e shëndetit publik. E cila ka pasur efektin e menjhershëm si në aspektin shëndetësor ashtu edhe në atë ekonomik. Sot jemi në ditën e fundit para vendosjes së masave strikte që janë në zbatim nga nesër, dhe unë nuk do të flas sa i përket efektivitetit të masave në pjesën e shëndetit publik. Pra unë do të flas sot nga aspekti i 15,000 kompanive të cilat unë i përfaqësoj dhe të cilat janë shtylla e ndërtimit të shtetit, punësojnë mbi 150,000 punëtorë, dhe kontribuojnë në mbi 80% të buxhetit të Kosovës. Prandaj e besoj se e kam kompetencën e plotë profesionale që të flas për pjesën e ndikimeve në ekonomi. Për këtë unë kam disa konstatime dhe disa pyetje:

Për këtë kam disa konstatime dhe disa pyetje:

- ❖ Duhet të jetë e qartë për të gjithë akterët institucional që ne, përfaqësuesit e biznesit, për politikën që kanë të bëjnë me biznesin, jemi njëjtë si OBSH të pjesa e politikave shëndetësore, ndërsa ne tek sot e formuam një grup koordinues, pra 31 ditë pas fillimit të masave kufizuese. Konsultat me ne po bëhen pasi që po merren vendimet. E kemi një vendim dhe një aneks të cilin ne ende nuk e kemi parë, dhe kërkoj që ky aneks të shpalojë sot ose të thirret takimi e kë saj trupe koordinuese, për ta diskutuar në mënyrë që të mos lejojmë që anomalitë të cilat na kanë ndodh dje të na ndodhin nesër dhe ditëve vijuese. Në disa raste kur kemi bërë presion pozitiv, për veprime pozitive për ekonominë, jemi trajtuar ose si të padijshëm, ose si opozitë. Kjo është e paprecedentë pasi që ne jemi partnerë.
- ❖ Ekonomia ka nevojë për qartësi. Ne falenderojmë të gjitha ministrinë për veprimet që kanë lehtësuar funksionimin e biznesit deri sot, por ende një pjesë e këtyre vendimeve ende janë të paqarta apo edhe të pazbatueshme në praktikën e funksionimit të bizneseve. E tërë kjo paqartësi dhe ambiguiteti në interpretim vetëm po e rritë dëmin në ekonomi. E di që Ministria i publikon vendimet e ndryshme mirëpo është një problematikë, të gjitha vendet e kemi të dedikuar një vend për biznese dhe për pjesën e ekonomisë i cili mundëson qartë dhe në kohë reale të kemi të dhëna dhe qartësi sa i përket mendimeve dhe sa i përket pikave kufitare, komunikimit me institucionel, lejeve të ndryshme, e kështu me radhë. Besoj është koha që të mendojmë që të kemi njëtransparencë dhe qartësi të plotë në lidhje me vendimet që i marrim dhe kufizimeve që ndikojnë drejtëpërdrejtë në biznesin.
- ❖ Ne e kemi përshëndetur pakon emergjente, por ne ende besojmë që e njehta do të duhe të avancohet konform dëmit që është bërë në ekonomi. Jo të bëhet kompenzimi i dëmit mirëpo zvogëlimi i tij, ne kemi kërkuar vlerën 5% të GDP-së të vendit, dhe e njehta që të mos e lejoj thellimin e hendekut në mes të ardhurave në sektorin publik dhe të ardhurave në sektorin privat. Personalisht po frigohem se në këtë rast ky qëllim nuk është arritur, si rezultata në të ardhmën shumica e punëtorëve do të kërkojnë që të punësohen në sektor publik apo të ikin nga shteti. Ne besojmë se duhet pasur një pajtueshmëri politike dhe shoqërore sa i përket këtij aspekti. Kjo është arsye pse i kemi takuar të gjitha grupet parlamentare deri sot, ku sot do të takojmë edhe grupin parlamentar të Vetëvendosjes, për të arritur një konsensus që ka nevojë që procedurat të përkrahen dhe të lehtësohen. Një gjë e tillë nuk është bërë për t'i shku mbrapa askujt, për këtë i drejtohem Ministrisë Bislimi i cili nuk është hera e parë që na thimbon, mirëpo nuk është viti i parë që ne përballemi me qeverinë dhe politikën, dhe besoj që një gjë e tillë tejkalohe. Për të qartësuar dhe lehtësuar zbatimin e saj në apsketin procedural dhe ligjor, ne besojmë që duhet një pajtueshmëri e gjerë politike dhe shoqërore, prandaj bashkë me Drejtorin e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, jemi takuar me të gjitha grupet parlamentare, për të kërkuar ndërtimin e kësaj pajtueshmërie, mëse të nevojshme, jo vetëm në këtë fazë por edhe në fazën e transformimit ekonomik, që është i domosdoshëm pas pandemisë. Unë kam frikë që

jemi në një rrugë ku zbatimi i pakos ka humbur derën e vet, prandaj duhet një unitet që të jemi sa më efikas në zbatimin e saj.

Sa i përket pyetjeve për të cilat thash që do t'i parashtroj lidhur me masat që janë propozuar dje, por edhe në përgjithësi me të ardhmën dhe pos-trajtimin e dëmeve të pandemisë.

- 1) Stina e pranverës e shton aktivitetin e bujqve, përfshirë mbjelljet pranverore, përpunimet e ushqimit, etj. Ky aktivitet është esencial për furnizimin dhe mirëqenien e mijërave familjeve në vendin tonë. Pyetje që shkon drejtëpëdrejtë për Ministrin e Ekonomisë, por nëpërgjithësi edhe për Kësillin: si është menduar të veprohet më këtë sektor. Ne propozojmë që të gjithë punëtorët në sektorin e bujqësisë, të lëvizin prej orës 6:00 – 19:00, kur pëfundon puna në ferma, dhe ata të identifikohen sipas numrit përkatës identifikues të fermerit.
- 2) Si është menduar çështja e sigurimit fizik të objekteve dhe pronave të bizneseve? Objektet duhet të sigurohen 24 orë, prandaj lëvizjet e punëtorëve të sigurimit fizik dhe kompanitë e sigurimit fizik, duhet ta kenë të mundur operimin dhe lëvizjen, gjatë 24 orëve;
- 3) A është menduar për pjesën e mallrave që eksportohen? Shumë eksporte janë të kontraktuara dhe ju e cekët Ministre Hajdari se janë krijuar koridore, dhe besoj se ne duhet me kriju koridore dhe përbrenda në mënyrë që mallrat të lëvizin lirshëm dhe pa pengesa. Që dy ditë kemi bllokim të eksportit sa për informacionin e juaj.
- 4) Si është menduar të organizohet shitja me pakicë, marrë parasysh që qytetarët e fundit që mund të furnizohen, në bazë të kufizimeve të reja që janë publikuar është vetëm pas orës 21:00? Organizimi i punës së marketeve nga mëngjesi deri në orën 23:00 në këtë kohë është më e vështirë. Këtu kemi të bëjmë edhe me transportin e punëtorëve dhe jo vetëm në këtë sektor. Në rrethana që me informacionet që i kemi ne nuk lejohet që të jetë më shumë se një punëtorë në automjet? Si mund të organizohet?
- 5) E fundit dhe shumë me rëndësi e konsideroj: a ka apo si do të veprohet për një një strategji dalëse pas datës 4 Maj 2020? Spanja ndër shtetet me të goditura, që ende po ballafaqohet me qindra të vdekur në ditë, dje filloj hapjen graduale. Njëjtë ka vepru edhe fqinji ynë, Maqedonia Veriore, së paku është duke e bërë një plan bashkë me organizatat e biznesit. Ku jemi ne në këtë aspekt? A kemi analiza që na mundësojnë më marr vendime racionale, që edhe e ruajnë shëndetin publik edhe e minimizojnë dëmin në ekonomi? Ne duhet të fillojmë të mendojmë hapjen graduale të ekonomisë, pas datës 4 Maj.

Unë edhe një herë e ofroj angazhimin tim personal dhe të Odës për të përballuar me lehtë dhe së bashku këtë situatë, që të kemi më pak nevojë për respiratorë në shëndetësi dhe në ekonomi. Ju falenderoj për vëmendjen!

Edhe një çështje Ministre, domthënë ta kemi listën dhe ta diskutojmë listën. E dëgjova dhe Ministrin Abdixhiku i cili potencoi disa veprimtari në mënyrë që kur të fillojmë nesër të mos kemi probleme edhe nevojë me diskutu secilin detaj me secilin institucion.

**Lindita Daija:** Berat Faleminderit! Ministre Rozeta në radhë është z.Arian Zeka.

**Arian Zeka:** Faleminderit shumë Lindita. Të nderuar ministra, të nderuar kolegë nga asociacionet e biznesit, më lejoni që t'i them disa fjalë. Singërisht besoj se ky takim i Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik, jo vetëm për shkak të funksionit të cilin e ka që është edhe të koordinoj politika të cilat kanë për qëllim mbështetjen e zhvillimit ekonomik edhe të ndëgjojë zërin e sektorit privat, por edhe duke ndjekur praktikata e shteteve të rajonit që në ditët e para të hyrjes në krizë, i kanë mbledhur trupat e tillë ashtu që të mundësojnë një dialog të përgjithshëm. E vërtetë është ajo që u tha, se ka pasur një komunikim dhe dialog, megjithatë nuk ka pasur një koordinim. Pra përmes dialogut asociacionet e biznesit nuk kanë arritur që të shtyjnë as minimumin e rekomandimeve të tyre dhe një vendim i cili është marrë në ndërkohë, realisht ka qenë konfuz dhe hutues dhe asnjëherë nuk është diskutuar me



asociacionet e biznesit. Për të sqaruar për dikë që mund të reagoj pas këtij adresimi, une e di që ne nuk marrim vendime ekzekutive dhe nuk kemi rol në marrjen e tyre, megjithatë ne mund të japim rekomandime të vlefshme dhe në një demokraci normale është e kuptueshme që të merren parasyshtë propozimet e asociacioneve të biznesit, sidomos kur ato janë të shëndosha.

- ❖ Të ndërlidhem me këtë do të doja që të kërkoj që lista e aktiviteteve ekonomike apo e bizneseve që do të lejohet të punojnë pas ditës së nesërme, pra atë që Ministria Hajdari e potencoi se lista do të përpilohet gjatë ditës së nesërme të marr në konsideratë një numër më të gjërë të kodeve NACE, pra jo vetëm atyre që shesin produkte esenciale, por edhe për ata nga fusha e teknologjisë dhe informacionit. Nëse e kemi pasur diku një bilanc pozitiv të pagesave gjatë gjithë këtyre viteve, atëhere është sektori i shërbimit dhe një asnjë mënyrë nuk duhet të marrim vendime të cilat e ndalin aktivitetin e bizneseve nga fusha e teknologjisë dhe informacionit dhe atyre që ofrojnë shërbime për kompanitë jashtë vendit, meqenëse ndërprerja e kontratave në këtë moment do ishte pasoja shkatërruese për një periudhë afatëgjate për këto ndërmarrje. Do të kisha kërkuar nga Ministria qysh sot që të ndaj draftin e atij udhëzimi që ta ndaj me ne në atë grupin virtual që e kemi, në mënyrë që edhe ne të mund të japim kontributin tonë dhe të mos kemi ankesa nga ana e bizneseve gjatë ditës së nesërme.

Meqenëse jemi ndër organizatat themeluese të Këshillit Kombëtar të Zhvillimit Ekonomik dhe gjithmonë kemi promovuar idenë e një partneriteti publiku-privat dhe vazhdimisht bëjmë thirrje për avancim të këtij partneriteti dhe jo rënim të tij, do të kisha lutur të gjithë hisedarët, pra ata qeveritar dhe jo qeveritar, që të kenë kujdesë me diskursin e tyre meqë odat nuk i shkojnë askujt mbrapa. Odat janë liderë të biznesve dhe ata iniciojnë edhe politika, edhe aktivitete dhe rrejdhimisht dëshirojmë që të punojmë krahas me të gjithë hisedarët politik dhe jo-plotik. Pjesa dërmuese e atyre kërkesave që kemi tashmë janë mbuluar nga Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, z.Berat Rukiqi.

Unë edhe një herë po e potencoj atë që e kemi thënë goxha shpesh ditët e kaluara që shuma e Pakos ka mundur të jetë më e madhe, pra kemi mundur të sigurojmë burime të financimit. Kryeministri e tha që kjo Pako Emergjente për nga vetë terminologjia e saj, pra Emergjente, është një ndihmë që i jepet pacientit në ditët e para dhe nëse kjo vërtetë është ajo pako, atëhere pacienti tashmë ka ndërruar jetë për shkak që jemi shumë vonë me implementimin.

**Lindita Daija:** Faleminderit Arian! Ministre Hajdari, në chat, për të cilën kuptoj se ju nuk keni qasje kemi dy opsione apo propozime, të vazhdojmë edhe me folësin e fundit dhe pastaj ju si ministra të i përgjigjeni disa pyetjeve. Apo të përgjigjeni në pyetje e pastaj të vazhdojmë me folësin e fundit. Vendimi është i juaji.

**Rozeta Hajdari:** Faleminderit Linditë, vazhdojmë me folësin e fundit pastaj përgjigjemi.

**Besnik Bislimi:** Më falni, nëse më lejoni vetëm shkurtimisht me u përgjigj se më duhet me ikë.

**Lindita Daija:** Në rregull Ministër!

**Besnik Bislimi:** shkurtimisht, një dokument që ma keni sjell ju si Sekretariat i KKZHE-së, që mirret me parashikimin për ndikimin e pandemisë në ekonominë e Kosovës thot që deri tani, rënia e GDP-së parashihet me qenë diku 140 – 147 milion Euro për çdo muaj. Ne masat i kemi fillu me 15 mars, domethënë tash jemi me 14 prill do të thot ende nuk ka kaluar 1 muaj i plotë, që do të thotë që masat në total deri tani kanë mund me qenë rreth 140 milion Euro me humbje. Në qoftëse sipas të njejtave parashikime kriza vazhdon për 3 muaj, do të thot përfshihen edhe muaji prill dhe muaji maj, deri në mes të qershorit, humbjet pritet të shkojnë deri ne 441 milion Euro. Po i përsëris është fjala për parashikimet që kanë ardhur nga KKZHE-ja.

**Lindita Daija:** gjegjësitë nga Sekretariati, më falni, mirëpo kjo del edhe si dokument prej Këshillit.

**Besnik Bislimi:** u tha edhe prej parafolësve që Pakoja Emergjente nuk i adreson, por humbjet emergjente vetëm për dy muajt e parë edhe nuk synon mbulimin e të gjitha humbjeve. Synon zbutjen e humbjeve. Do të thot, ne synojmë që këto humbje të i shpërndajmë në mënyrë sa më të barabartë për të gjithë participantët në shoqëri. Pakoja ka 190 milion Euro, plus shtojani 100 milion Euro deri tash humbje të shtetit që munden me qenë. Do të thot pakoja është dyfishi i humbjeve mujore të ekonomisë. Ndërsa tash të themi që pakoja është e pamjaftueshme duke i ditur kufizimet që i ka Kosova për politikat fiskale, duke e parë bllokatat që po bëhen dhe na pamundësojnë huamarrjen është shumë joserioze. Z. Rukiqi kur e filloi fjalimin e tij tha, Kryeministri do të ishte mirë të na ndëgju, po mirë shkoj e kuptojmë dhe si është dashur ne me u taku qysh në fillim, qysh nuk po i marrim parasysh si përfaqësues dhe si ne po i marrim vendimet pa i pyetur fare. Dua të sqaroj që në vendimet i kemi marr me 30 mars, dhe deri atëhere jam takuar me të gjitha odat, disa prej tyre edhe dy-tri herë. Nuk është mirë me shpërnda të pa vërteta. Z. Rukiqi tha duhet me qenë transparent, ai ka deklaruar se Bislimi po na thumbon, po na thot të padijshëm, po na thot opozitë. Z. Rukiqi për hirë të transparencës, unë nuk kam asnjë deklaratë nga ju prej ditës që kam filluar punën si Ministër i Financave dhe Transfereve me e mbështet qeverinë. Deri tani ndoshta mund të them se opozitë më e madhe e qeverisë ka keni qenë ju, po e them shumë hapur. Për hirë të transparencës, është mirë të tregoni se qysh po mundoheni të i bllokoni odat duke thënë ta rrëzojmë këtë qeveri se Hashim Thaqi na ka premtuar 300 milion Euro, për hirë të transparencës po e them. Nuk është mirë të dilni hapur kundër qeverisë përderisa ne po mundohemi të marrim masa për ekonominë. Nuk jeni duke i përfaqësuar ato biznese anëtare, nëse dëshironi ejani në zyrë të ju tregoj mesazhet që kam pranuar nga bizneset që janë anëtarë tuaj të cilët po deklarohen se po punoni kundër qeverisë dhe kundër bizneseve. Për këtë jam deklaruar edhe më herët duke thënë se disa prej odave po e bëjnë këtë dhe gjithëmonë keni qenë ju që keni reaguuar se keni mendu se po ju drejtohem juve. Kjo që po bëni mund të i kushtoj vetëm komunitetit të biznesit. Ndoshta ju dilni fitues, ndoshta merrni ndonjë privilegj por jo bizneset. Kaq kisha.

**Rozeta Hajdari:** Ministri Bislimi faleminderit! Ne sot jemi këtu që t'i dëgjojmë bizneset dhe e di që shumë ankesa kemi por edhe unë dua të përgjigjem. Është me rëndësi të sqarojmë ku jemi. Edhe unë e di që jemi takuar shpesh dhe kemi pasur vendime në mbërme dhe të nesërmën në mëgjesë është dashur të jenë urdhëresat, si ka ndodh me 30 mars. Po po ndihem përgjegjëse si Ministre e EPTINIS që nuk e kemi ftuar këtë Këshill më heret, por sa do të kishin prit bizneset derisa të i kryejm këto procedura dhe takime formale e jo përgjigje ad-hoc e të shpejta për bizneset nëzberthimin e të gjitha urdhëresave për zbatimet të cilat i ka ndërmarr qeveria. Ne e kemi pasur shumë vendime që janë marr në mbërme dhe menjëher në orën 5:00-6:00 është dashur të nxjerrim udhëzimet për mbarvajtjen ekonomike. Në këtë rast po ndihem përgjegjëse dhe e kuptoj se u paskem dasht me pas takime më formale por kam menduar që ashtu i përgjigjem më shpejtë si kam çdo kërkesë, siq kam bërë ndaj z.Rukiq, z.Zeka dhe të tjerë të cilën kanë ardhur në kabinetin tim, kemi pasur diskutime dhe gjitha shqetësimet. E poashtu edhe Ministri i Financave ka qenë në takime, gjithashtu ju kam ftuar edhe të jeni pjesë e takimeve ku një rastë është edhe Yllka Metaj, e cila ka ardhur me ekipin tuaj dhe i kam thënë që mund të vij edhe t'i dizajnojmë bashkë këto urdhëresa, siq edhe ka ndodh. Nuka dua ta mbroj qeverinë këtu, por e kuptoj Ministrin e Financave i cili është munduar të jetë sa më afër bizneseve dhe ju ka ndëgjuar gjatë këtyre ditëve të pandemisë, por prap se prap atmosfera është që të ju dëgjojmë sot dhe do të mundohemi që më tutje të bashkëpunojmë edhe më shumë. Faleminderit dhe i japim fjalën folësit të tretë.

**Lindita Daija:** Z. Skender Krasniqi.

**Skender Krasniqi:** Përshëndetje, ministra dhe kolegë të nderuar. Ne mendojmë si Odë e Afarizmit, se shtet i qëndrueshëm është kur ka biznes të qëndrueshëm. Prandaj pako e dytë duhet të jetë më e koordinuar me ne se deri më tash. Ne e kemi shprehur mes letrave shqetësimin për shpërndarjen e pakos së parë, për shkak se është llogaritur të ndahen rreth 40 milion Euro, ndërsa 15 milion Euro për paga shtesë për sektoret që janë të ndikuara nga koronavirusi. Ne mendojmë se pako do të duhet të shpërndahej më mirë dhe se shuma 41 milion Euro është e vogël në krahasim me nevojën që do të kenë bizneset në kohë kur do të aplikojnë. Kemi shprehur edhe shqetësim edhe për shumën 4 milion Euro për të papunët, ku përfituesit i bie të bien diku rreth 10,000 të papunë dhe në besojmë se numri i të papunëve do të jetë shumë më i madh. Gjithashtu mendojmë se vendimet e qeverisë duhet të jenë të zbatueshme në teren, meqë vazhdimisht po ka konfuzitet. Mirëpo ne besojmë se bashkarisht, sidomos përmes këtij këshilli ne mund të bashkëpunojmë shumë dhe të kemi një efekt më të madh për një interes të përbashkët. Pa zhvillim të biznesit nuk mund të ketë zhvillim as të shtetit e as të hyra të cilat qeveria i planifikon. Disa nga kërkesat që ne kemi janë:

- Të jepet mundësi a e kredive me një afat më të gjatë për bizneset të cilat kanë nevojë;
- Të prolongohen pagesat e qirasë në kur biznset nuk kanë funksionuar, apo vetëm me kapacitete të vogla. Pra një gjë e tillë të jetë vendim i qeverisë dhe të mos mbetet në vullnetin e qira dhënësit;
- Të mbulohen mundësisht shpenzimet operationale për bizneset që nuk kanë mundësi të i mbulojnë;
- Të rritet Fondi për Garanci të Kredive;
- Të krijohet mundësia që marketet të funksionojnë në të gjitha hapsirat dhe jo të limitohen
- Shihet mundësia e hapjes së dyqaneve, ndërtimitarisë, dyqanet e autopjesëve, posta e shpejtë, libraritë përdërisa edhe mësimi online po vazhdon;
- Si dhe përgjigjet në reagimet e OAK në lidhje me kërkesën për gjetjen e një zgjidhje për ato komuna ku bankat e kanë ndërprerë aktivitetet, meqë bizneset nuk po mund të kryejn obligimet bankare si p.sh në Malisheve;
- Lehtësira në qarkullimin e bizneseve mes Kosovës dhe Shqipërisë në këtë kohë.

E kuptojmë që gjithçka po zhvillohet shumë shpejtë dhe nga ana jonë kërkesat janë të tilla për një intervenim të menjëhershëm, mirëpo ne besojmë se me një bashkëpunim të mirëfillt nga të dy anët mund të arrihet. Gjithashtu besoj që pako dy do të jetë shumë më e koordinuar me ne si përfaqësues të bizneseve. Faleminderit shumë, meqë s'dua të ju marr kohë më shumë.

**Lindita Daija:** Faleminderit shumë z. Krasniqi. Ministre Hajdari, kemi kërkesë nga Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës që të marr fjalën edhe pse është një pikë shtesë meqë agjenda me kohë të rregullt ka përfunduar që 10 minuta. Mirëpo nëse keni mirëkuptim kishte shumë komente në emër të tij personal.

**Rozeta Hajdari:** Nëse është për ekonomi, sot është takimi për zhvillimin ekonomik dhe t'i adresojmë çështjet në lidhje me ndikimin dhe sfidat që i kemi në ekonomi dhe kisha dashur si Ministre për Ekonomi t'i kem të gjitha pyetjet e fokusuar tek kjo temë dhe jo politikë. Falemnderit!

**Berat Rukiqi:** normalisht që takimi dhe fjalimi im ishte për tema ekonomike, mirëpo Ministri Bislimi bëri pëgjigje politike. Secili e flet atë çka mendon dhe unë do të vazhdoj t'a flas atë që mendoj. Mendoj që kemi nevojë për më shumë koordinim. E dyta sa i përket akuzave të bazuar në spekulime, tash nuk është nivelin tim të i përgjigjem në atë mënyrë Ministrit por vetëm për hirë të procesverbalit dua të them se ajo çka përfaqësoj unë është vetëm ajo që vjen prej komunitetit të biznesit. Unë nuk mund të jem uniform as me qeverinë as me parlamentin dhe me asnjë institucion tjetër nëse ka diçka që bjen në kundërshtim me interesat e biznesit. Unë përfaqësoj ekskluzivisht komunitetin e biznesit. Për spekulimet

që i tha Ministri Bislimi është mirë të jenë në procesverbal dhe të njejta pastaj duhet edhe të argumentohen. Kjo krijon dëm të madh në mënyrën se si ne punojmë dhe e dëmton komplet partenritetin dhe nuk ka zhvillim papartneritet, pa një debat korrekt apo kritika pozitive. Nëse ne jemi pozitiv për cdo vendim të qeverisë atëherë humb roli jonë që e kemi si përfaqësues. Prandaj nuk është mirë që të përdoret foltorja e KKZHE-së për të deklaruar spekulime ashtu si bëri Ministri Bislimi. Të njejtë do t'i përgjigjem edhe në forma të tjera të cilat do të jenë ligjore dhe të bazuara në kapacitetin tim si Kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës. Faleminderit!

**Rozeta Hajdari:** është me rëndësi që të kemi një dialog sa më konstruktiv. Sot është që t'ju përgjigjem un si Ministre e ekonomisë për pyetjet që i keni drejtuar.

Ju përmendet që sa po takohet ky këshill por si Ministre mendoj se edhe ju e mbani në mend, e di që nuk është asnjëher e mjaftueshme, por jemi takuar disa herë në kabinetim tim ku ishte edhe Ministri Vitia edhe Ministri Mustafa, Ministri Bislimi, duke ju dëgjuar edhe në zyret e Kryeministrit, në zyre të Ministrisë së Financave, në kabinetin tim dhe mendoj se për aq sa kemi pasur mundësi edhe në këtë pandemi, ku e pranoj që nuk ka pasur koordinim sa a qënë i nevojshëm mes ministir-komunë si pasojë e COVID-19 ku ka pasur shumë paqartësi për zbatimin e masave që janë marr nga qeveria. Jemi të vetëdijshëm për këtë. Vetëm nuk më pëlqen kur po e potenconi se sot po takohemi për herë tëparë këtu kur jemi dëshmitar ju dhe tjerat oda se unë shpesh ju kam takuar dhe Ministri Bislimi poashtu dhe të tjerë. Poashtu edhe zëvendës kryeministria si z. Hoti dhe z. Abazi. Për aq sa kemi pasur mundësi ne ju kemi përgjigjur në mënyrë ad hoc të gjithëve. Ndoshta edhe kjo paska qenë e gabueshme që kemi qenë të hapur për secilën odë ekonomike. Megjithatë gjithëmonë ka vend për përmisim.

Besoj që unë me kolegët e mij pranojmë dhe jemi të hapur për çdo kërkesë konstruktive.

Unë s'dua të shkojë më gjatë. Çka dua të them është se nëse ne e mbrij njëbashkëpunim dhe konsensus ju premtoj se do të marri parasysh rekomandimet e juaja për aq sa i mundëson buxheti i Kosovës dhe mundësia e ekonomisë për t'i adresuar të gjitha kërkesat. Jam e vetdijshme unë dhe ministrat, që arka e shtatit mbushet nga biznesi dhe duam të jemi sa më afër këtij dialogu publiko-privat.

- 1) Në lidhje me pyetjet konkrete që kishit z. Rukiqi në lidhje me bizneset ju njoftoj se NACE kodet, janë disa që do të mbyllen prap. Respektivisht do të vjen sektori i ndërtimtarisë që ka ardhur si kërkesë nga Ministri Vitia. E cila është më se e nevojshme të mbyllet për shkak të kushteve që i inponon puna në këtë sektor në lidhje me distancën 2m që nuk mund të zbatohet. Gjithashtu dyqanet me vegla dhe zallë nuk janë funksionale në këtë kohë që e vështirëson operimin. Gjithashtu edhe qarkullimi i punëtorëve në numër të madh në një automjet nuk është sipas normave të distancës së nevojshme. Kjo për të ruajtur jetën e qytetarëve.
- 2) Do të ndajmë me ju listën e kodeve NACE se çka kemi propozu si draft të mbyllur, po rju lutem për mirëkuptim, meqë disa nga rekomandimet që do të vijn nga ju nuk do të mirren parasysh për shkak të ruajtjes së jetës së qytetarit si p.sh prodhimi i lëkurës.
- 3) Për qarkullimin e punëtorëve, qytetarëve Ministri Vitija mbrëm e ka shpjeguar orarin me orë sipas shifrës së dytë të numrit identifikues të personit në letërnjoftim, por zinxhiri i funrnizimit do të jetë i lirë. Respektivisht punëtorët do të zbrkajnë formën në ATK, sistemin EDI e cila konfirmohet me vulën nga vet biznesi për qarkullim të lirë të punëtorëve. Por ata nuk lejohen të qarkullojnë nëse komuna është e karantimuar. Do t'i kisha dhënë fjalën Ministrin Vitia që t'i sqaroj më mirë disa nga rregullat dhe arsyet e këtyre vendimeve.
- 4) Do të marrim parasysh kërkesën për lejen e punëtorëve të sigurimit. Jemi gjithashtu të vetëdijshëm se disa nga këta punëtorë janë të komunave të tjera.
- 5) Qështje që përfshijnë si importin e lëndës së parë deri tek prodhimi të gjitha janë të lira të punojnë. Ndoshta pse nuk është ndar akoma me ju drafti i vendimit ka paqartësi por do ta ndajmë së shpejti.

Ju garantoj që si ministre po mundohem së paku 50% të bizneseve të i mbajmë aktiv dhe funksional, megjithëse kërkesa është 80% e më shumë. Ndoshta e harrova ndonjë pyetje z. Rukiqi. Në lidhje me postën e shpejte, pyetja nga z. Krasniqi. Ndërmarrjet publike që përfshijnë Postën, KEK-un etj këto të gjitha e kanë qarkullimin e lirë 24 orë.

**Lindita Daija:** Ministre, në chat i kemi dy pyetje, aspekte që po drejtohen. Ka pyetje edhe për ministrat e tjerë. Gjithashtu a do të ju jepet fjala të tjerëve që janë duke kërkuar?

Në kushte normale në fund të agjendës parashihet diskutimi prej 20 minuta. Duke pasur parasysh që të gjithë e kemi pasur agjendën e limituar edhe pse i kam lutur për mirëkuptim pasi që është takimi i parë në këtë format dhe vetëmse e kemi kaluar kohën është vendim i juaji. Varet edhe nga koha e juaj.

Për Ministrin Mustafa nga Oda e Afarizmit ka pyetje a do të lirohet qiraja?

Pastaj z. Lumnije Ajdini kërkon fjalën dhe ka disa pyetje.

Nga Shoqata e Drurit dhe KIMERK është kërkuar që për shkak të paisjeve me dorëza, veshje, maska të vazhdoj puna në sektorin e ndërtimitarisë.

Edhe nga Oda Ekonomike është një koment që po rrezikohet zinxhiri i furnizimit për shkak të këtyre ndalesave.

Besoje që ju vendosni nëse ministrat respektiv të i përgjigjen pyetjeve.

**Rozeta Hajdari:** Lidnita dhe përfaqësues të odave, për shkak që ne sot pikërisht këto pyetje që po i parashtroni, në agjendat e kemi të paraparë që të ulemi së bashku dhe t'i konkretizojmë të gjitha anekset. Ministri Vitia është edhe udhëheqës i këtij grupi për qështjen e pandemisë. Rrjedhimisht çdo vonesë këtu reuzlton ne vendime të vonuar rreth këtyre qështjeve. Ju kisha lutur që pyetjet t'i drejtoni të gjitha bashkë në formën online dhe unë do t'i përgjigjem derisa jam në puntori me ministrat e tjerë, që të jemi sa më të shpejtë në reagim me sqarimet e nevojshme. Prandaj kisha me vendo mos të zgjatim. Tani fjala për Ministrin Vitia.

**Arben Vitia:** Faleminderit Ministre, të nderuar pjesëmarrës të këtij takimi më lejoni të bashkëndjej me ju edhe në aspektin e dëmeve ekonomike sepse normalisht edhe pse nuk jam i fushës, ka kohë që masat që janë ndërmarr dhe në koordinim me Ministren Hajdari, e cila ka lobu dhe është mundu që një pjesë e ekonomisë duhet të vazhdoj, për të mos kaluar në një rrejdha pas të cilave është e vështirë të kthehen në normalitet.

Mirëpo situata deri para 10 ditëve ka qenë në kontrollë sepse të gjitha rastet identifikuar ishin kontakte të personave që janë identifikuar më heret. Ditëve të fundit kemi pasur raste si "community spreaders" të cilët janë elektrone të lira që mund të shetisin kudo dhe mund të jenë bartës, ashtu si une apo ju sot mund të jeni bartës apo veçse të infektuar si pasoj e këtyre rasteve. Masat që kemi marr ne kanë qenë konform me Ministrinë e EPTINIS, mirëpo për momentin jemi në një situatë ku kemi dy modele para vetes. Është modeli i Kinës, do të thot me "total lockdown" ku njerëzit edhe me ushtri janë mbyllur mbrenda dhe kemi modelin e Tajvanit ku në bashkëpunim me qytetarët, pa masa strikte kanë arritur ta ulin nivelin e të infektuarëve. Ne në fakt nuk mund as në një anë e as në tjetrën sepse e pamë që megjithëse në fillim patëm bashkëpunimin e qytetarëve ata me kohë filluan të mos bëjnë një gjë të tillë. Kjo e bëri të pashmangshme qëtë vazhdojmë me masat qëishin më heret, dhe kemi qenë të detyruar të marrim këto masa përkundër indistimit të Ministres Hajdari, por edhe të Ministrit Bislimi. Përfundimisht e kemi marr një model si Austria, për këtë shkak që dua ta shpjegoj.

Masat që morrëm mbrëm ishin të pashmangshme. Nëse nuk do t'i kishim marr, do të na ishte dasht me i marr pas 2-3 jave ku do të kishim rritje eksponenciale klasike. Kur do tëishin mbushur të gjitha spitalet dhe institucionet tona shëndetësore me pacient atëherë kishim qenëtë detyruar prap të i marrim këto masa. Në anën tjetër, po e quaj kushtimish kjo agonia ekonomike, për shkak të këtyre masave do të kishte vazhduar dhe prap do të ishim në pikën e njejt. Prandaj i kemi marr këto masa që pas 4 majit të i

heqim masat dhe t'i lirojmë të operojnë këto biznese pasi të kemi ulë nivelin e për hapjes nga një person në një tjetër.

NACE kodet të cilat në i kemi kërkuar nga Ministria Hajdari mirëkuptimin, siq janë ndërtimet, ka qenë e pashmangshme jo vetëm për pamundësinë e krijimit të distancës sociale mes punëtorëve, por kemi pasur raste nga pika shumë të nxehta si nga Malisheva, konkretisht nga Banja e Malishevës si pika më e nxehtë të infeksionit tani, përmes rrugëve alternative kanë ardhur si punëtorë ndërtimi në shumë qytete e kryesisht në Prishtinë. Kjo ka paraqitur një rrezik të jashtëzakonshëm për epidemi të shkallës së gjërë në Prishtinë.

Pas këtij takimi do të mbledhemi me të gjithë ministrat dhe profesionist të fushës dhe të shohim mundësitë për hapjen e bizneseve të cilat nuk paraqesin rrezik në këtë aspekt. Mirëpo shpresojmë mirëkuptimin tuaj që disa sektore si ai i ndërtimit, po e përsëris, jo pse duam ne po për shkak të atyre kushteve që përmenda dhe rrezikut potencial na duhet t'i ndalojmë deri me datën 4 maj. Shpresojmë që pas 4 majit pasi të ulet numri i të infektuarëve dhe RO-ja që tash është nga 5-6 në rrezik tek në 1, një pjesë e madhe e sektoreve do të lejohen të operojnë.

Jam i hapur për pyetje nëse ka diçka dhe ju falemnderit që më dëgjuat.

**Lindita Daija:** sa për informim këtu në chat ka shumëpyetje për sektor, sidomos për atë të prodhimit. Ka shumë kërkesa për të marr fjalën nga AKB znj. Lumnje Ajdini, Arjeta, Klubi i Prodhuesëve, Shoqata e Përpunimit të Drurit. Por tani do të kemi më shumë takime dhe në dy nivele atë të Grupit Punues, i cili do të bëjë punë intensive dhe në takimet e këtij formati të KKZHE-së me rezultate ku do të jetë mundësia e vazhdimit të diskutimit. Mirëpo vendimi mebetet te ju, edhpsë kërkesat janë aq të shumta sa që nuk po arrij as t'i lexoj.

E vetmja mundësi është ose ju drejtojmë pyetjet tash ose ju dërgojmë përmes emailit.

**Rozeta Hajdari:** Falemnderit Lindita dhe të gjithëve. Është shumë e kuptueshme të na drejtohen pyetje por pikërisht për këto pyetje ne duhet të takohemi me ministra që të azhurnojmë listën dhe t'i publikojmë të gjitha anekset për të qartësuar gjërat për bizneset. Prandaj sa më heret që na i dërgoni pyetjet edhe ne do t'i përgjigjemi në mundësinë e parë, mirëpo të na kuptoni që do të jemi të angazhuar. Situata është shumë dinamike dhe çdo moment mund të bëhet edhe më keq me rastet e të sëmurëve.

**Arben Vitia:** ose më mirë. Mirëpo kjo është një situatë dinamike, të cilën çdo sugjerim ose këshillë e juaja do të analizohet e situatës dhe mund që shumë prej tyre të përfshihen gjatë këtyre ditëve. Domethënë është një situat që mund të ndryshoj nga ora në orë. Pra 3 ditëve ka qenë, kushtimisht po them, nën kontroll, megjithëse ne e kemi ditë që ky rrezikë është potencial dhe pas rasteve në Prishtinë, Ferizaj e sidomos Prizren ndryshoj komplet situata. Mund të ndryshoj akoma për të keq dhe të ketë kufizim akoma më shumë, por mund të ndryshoj edhe për të mirë dhe të ketë lirime edhe më heret se 4 maj. Prandaj është e rëndësishme që të jemi unik në këtë situatë, sepse sa më shumë që dërgohet mesazh di dyfisht tek qytetarët koordinimi do të jetë më problematik.

**Lindita Daija:** Falemnderit shumë! Atëhere ne si Sekretariat po i mbledhim të gjitha pyetjet dhe po i organizojmë në bazë të ministrave për kë janë drejtuar dhe besoj se Ministre Hajdari do të vendosni për takimin e Grupit Koordinues sa më parë. Kemi kërkesa nga z. Berat Rukiqi që të mbajmë takim qysh sot në orën 20:00. Por sipas agjendës tuaj sa më heret që mund të fillojmë aq më mirë. Ne si Sekretariat do të qëndrojmë në dispozicion në çdo kohë.

Falemnderit edhe një herë të gjithë ministrave dhe po ia lë fjalën për konkludim Ministres Hajdari.

**Rozeta Hajdari:** Faleminderit Linditë, faleminderit të gjithëve. Poashtu edhe Ministrit Vitia që mundohet me reflektu pozitiv përkundër situatës. Ne si ministra sot do të punojmë të gjithë së bashku, prandaj nuk do të mund të mbajm mbledhjen sot me ju. Por sa më shpejtë që është e mundur unë do t'i kthehem Sekretariatit me agjnden që e kam të lirë për takim.

Dua të potencoj që qëllimi jonë bashkëme Ministrin Bislimi dhe Vitia është që pas datës 4 maj të mund të hapin 80% të biznesve dhe duam që ta arrijmë këtë target. Por kjo krejt varet nga bashkëpunimi me qytetarët dhe ju bizneset.

Ju faleminderit shumë dhe besoj që do të shihemi shumë shpejtë dhe me Grupin Koordinues të takohem isa më shpejtë që mundemi.

Faleminderit!

**Lindita Daija:** Faleminderit!